



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Bashkia Krujë

---

**PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË RISKUT DHE KRIJIMIN E GRUPIT TE MENAXHIMIT STRATEGJIK NË BASHKINË KRUIJË**

Bazuar në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 10 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 si dhe në Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike”, me propozim të Nëpunësit të parë Autorizues të Bashkisë Krujë,

**URDHËROJ:**

1. Për funksionimin normal dhe në vazhdimësi të procesit të menaxhimit të riskut të krijohet ekipi i Menaxhimit të Riskut me përfaqësues nga çdo strukturë e Bashkisë Krujë si më poshtë:
  - Sekretari i Përgjithshëm i Bashkisë
  - Drejtoria e Financës
  - Drejtoria e Tatim Taksave
  - Drejtoria e Burimeve Njerezore
  - Drejtoria Juridike dhe Prokurimet
  - Drejtoria e Plan Kontr.dhe Zhvill. Territorit
  - Sektori i Auditimit të Brendshëm
  - Drejtoia e Menaxhimit të Pronave
  - Drejtoria e Shërbimit dhe Punëve Publike
  - Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social
  - Drejtoria e Arsimit Kulturës dhe Sportit
  - Administratori i Njësisë Administrative Fushe Kruje
  - Administratori i Njësisë Administrative Thumanë
  - Administratori i Njësisë Administrative Nikël



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Bashkia Krujë

- Administratori i Njesisë Administrative Bubq
  - Administratori i Njesisë Administrative Cudhi
2. Në përmbushje të përgjegjësive të tij, nëpunësi autorizues i delegon disa prej detyrave të veta për koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe koordinimin e riskut, punonjësve pjesë e strukturës së financës. Kordinatori i deleguar për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe riskun në Bashkinë Krujë caktohet znj.Yllka Kukulaj me detyre Përgjegjese e Buxhetit dhe Financës ne Drejtorinë e Ekonomise dhe Financës.
3. Grupi i Menaxhimit Strategjik të Bashkisë Krujë të jetë i përbërë si me poshtë

vijon:

	Kryetar i Bashkisë	Kryetar i Grupit
1. Artur Bushi	Kryetar i Bashkisë	Kryetar i Grupit
2. Rrahman Rraja	N/ Kryetar i Bashkisë	Anëtar
3. Gjon Bardhi	N/Kryetar i Bashkisë	Anëtar
4. Florind Cerhozi	Sekretar i Përgjithshëm	Anëtar
5. Xhemali Xhixha	Adm.Nj.A. Fushë Krujë	Anëtar
6. Griselda Mana	Adm.Nj.A. Thumanë	Anëtar
7. Xhek Xheka	Adm.Nj.A Nikël	Anëtar
8. Qemal Daci	Adm.Nj.A. Bubq	Anëtar
9. Osman Koni	Adm.Nj.A. Cudhi	Anëtar
10. Xhevahire Xhafa	Dr.Ek. dhe Financës	Anëtar
11. Mehmet Deliu	Dr. E Burimeve Njerëzore	Anëtar
12. Eglantina Subashi	Dr.Juridike dhe Prokurimet	Anëtar
13. Lindita Taci	Dr.Tatim Taksa	Anëtar
14. Aida Dedja	Dr.Plan.Kon.Zhv.Territorit	Anëtar
15. Qamil Leka	Dr.Menaxhimit Pronave	Anëtar
16. Riza Blushi	Dr.Sherb. dhe Punëve Publ.	Anëtar
17. Ilira Suta	Dr.Ndihm.Ekon. e Shërb.Soc.	Anëtar
18. Agim Nuna	Dr.Arsim Kulture Sport	Anëtar

4. Përgjegjësitë e çdo niveli të menaxhimit në fushën e menaxhimit të riskut janë si më poshtë:

Nëpunësi Autorizues si kordinator i riskut është përgjegjës për:

- Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut;
- Vlerësimin e sistemit të MR;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Bashkia Krujë

---

- Bashkërendimin e aktiviteteve në lidhje me menaxhimin e risqeve (krijimin e regjistrit të riskut të institucionit),
- Paraqitjen e raportit të përgjithshëm të GMS dhe Ministri;
- Këshillimin në lidhje me efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të MR;
- Informimin dhe komunikimin efektiv për risqet brenda njësisë publike dhe me njësitë e tjera publike me ndikim në veprimtarinë e tyre;
- Inkurajimin e kulturës së menaxhimit të riskut në të gjithë nivelet;
- Hartimin dhe ndjekjen e strategjisë së risqeve;
- Organizimin e trajnimeve për stafin e Bashkisë Krujë për MR.

Drejtorët dhe Administratorët e Njësive janë përgjegjës për:

- Vendosjen dhe miratimin e objektivave të strukturës së tyre;
- Identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të objektivave të tyre.
- Identifikimin, vlerësimin, përcaktimin e aktiviteteve të kontrollit për minimizimin e risqeve;
- Përgatitjen dhe përditësimin e regjistrit të riskut;
- Monitorimin në vazhdimësi të risqeve të identifikuara;
- Përgatitjen e planit të veprimit për aktivitet që ndërmerren për minimizimin e risqeve;
- Për risqet që janë vlerësuar të larta krahas planit të veprimit duhet të përgatitet dhe një raport argumentues.
- Të sigurojnë se të gjithë punonjësit janë të njohur me procesin e MR dhe me kërkesat e vendosura për këtë qëllim;
- Inkurajimin e kulturës së MR në të gjithë nivelet;

Auditimi i Brendshëm është përgjegjës për:

- Vlerësimin e sistemit të MR në Bashkinë Krujë;
- Të sigurojë efektivitet të mekanizmave të kontrollit, të vërë në dukje risqet, ose ngjarjet e padëshirueshme që mund të ndodhin si rezultat i mekanizmave të kontrollit të papërshtatshëm ose jo efektiv dhe të japë rekomandime që synojnë forcimin e tyre

GMS është përgjegjës për:

- Diskutimin dhe miratimin e strategjisë së riskut;
- Të sigurojë menaxhim efektiv të riskut në të gjithë Bashkinë Krujë;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Bashkia Krujë

---

- Të krijojë kushtet për komunikim efektiv në lidhje me risqet midis të gjitha palëve të interesuara;
- Të miratojë planin e veprimit për reagimin ndaj risqeve;
- Të ndjekë zbatimin e planit të veprimit;
- Të bëjë vlerësimin përfundimtar të risqeve të identifikuar në Bashkinë Krujë;
- Të sigurojë se regjistri i riskut për programe/objektiva specifik rishikohet jo më pak se dy herë në vit.

Detyrat e kordinatorit te deleguar të riskut janë:

- Përgatit kalendarin për procesin e menaxhimit të riskut dhe ja dërgon KR për miratim;
- Organizon procesin e punës për zbatimin e kalendarit të afateve që vendosen për menaxhimin e riskut;
- Mbledh regjistrat e risqeve të të gjithë strukturave të Bashkisë së bashku me planet e veprimit dhe përgatit një regjistër risku dhe plan veprimi të konsoliduar për Bashkinë Krujë për risqet më prioritare që nuk mund të menaxhohen nga vetë struktura;
- Bazuar në matricën e risqeve si dhe në planet e veprimit të çdo drejtorie, KDR përgatit raportin për menaxhimin e risqeve për GMS.

5. Afatet e kryerjes së aktiviteteve

- Çdo strukturë e Bashkisë brenda muajit Janar duhet të ketë përcaktuar dhe miratuar objektivat e punës për vitin korrent;
- Regjistri i risqeve duhet të hartohet deri në fund të muajit shkurt për MF duke marrë në konsideratë objektivat dhe planet operationale të punës së çdo strukture. Gjatë vitit, në rast se ka ndryshime në objektiva duhet të rishikohet dhe regjistri i risqeve;
- Brenda muajit mars, GMS bazuar në raportin e paraqitur nga NA si KR, analizon risqet me nivel të lartë, planin e masave të prezantuar në raport si dhe bën sugjerimet përkatëse për përmirësime;
- Gjatë procesit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, me përcaktimin e objektivave afatmesëm dhe vjetor duhet të identifikohen dhe risqet që lidhen me këto objektiva;
- Për monitorimin e detyrave të përcaktuara nga GMS, KR duhet të organizojë takime periodike, të paktën një herë në dy muaj, me menaxherët përgjegjës për ndjekjen e këtyre detyrave.

6. Në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e kordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinatorit të riskut në njësitë publike” do të gjeni informacionin më të plotë , që lidhet me ciklin e menaxhimit të riskut, përmënyrën se si duhet kuptuar dhe plotësuar regjistri i risqeve, plani i veprimit dhe formatet përkatëse.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Bashkia Krujë

---

*Konceptoi:* Yllka Kukulaj ,Pergjegjës  
*Konfirmoi:* Xhevahire Xhafa, Drejtor  
*Miratoi:* Florind Cerhozi, Sekretar i Përgjithshëm  
*Data:* 30.03.2017